



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Doretuar Pritjen/Prodato Received/Delivery | 06-07-2023 | 3 | viti god year |
| Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKAMBYCK | 5089/2023 | | 113 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 773/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.773/2023 të datës 24.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adrese banimi rruga e UÇK-së nga Komuna e Gjakovës kundër Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.07.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit _____

A.nr. 773/2023 e datës 24.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi, Vërejtja me numër 116/04-8113 e datës 20.04.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesi _____, me datë 24.05.2023, me numër protokolli 4399/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës, me datë 20.04.2023, i ka shqiptuar masën disiplinore Vërejtje me shkrim, lidhur me mos respektimin e orarit të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 29.05.2023, përmes e-mailit ka parashtruar kërkesë për përgjigje në ankesë, ndërsa me datë 02.06.2023, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën nr.773/2023 e datës 24.05.2023, me numër protokolli 4399/2023, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejta e datës 20.04.2023 e Udhëheqëses së Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës; e- maili 13.04.2023; Vendimi i datës 30.09.2022, për procedurat e ndërrimit dhe korrigjimit të emrit personal; e- maili i datës 19.03.2023; Akt emërimi A.E Nr. 01-112/02-37385 i datës 13.12.2021; e- maili i datës 30.05.2023; e- maili i datës 25.04.2023; e- maili i datës 19.04.2023; Flete dorëzimi i datës 20.04.2023; e- maili i datës 22.09.2023; e- maili i datës 12.12.2022;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit , **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit se, Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës, si mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë i ka shqiptuar vërejtjen me shkrim me numër 116/04-8113 të datës 20.04.2023, me arsyetimin se me datën 19.04.2023, qytetari në orën 09.16, është paraqitur në zyrën e ankuesit për të marrë shërbime të gjendjes civile në Zyrën në Poneshec, mirëpo edhe gjatë kohës së orarit të punës zyra e gjendjes civile në F.sg Poneshecë ka qenë e mbyllur dhe ankuesi nuk ka njoftuar mbikëqyrësen e drejtpërdrejt.

Kolegji, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se Zyra e Gjendjes Civile në f.sg Poneshecë ka qenë e mbyllur në kohën kur qytetari ka kërkuar shërbime në këtë zyrë, ankuesi kishte bërë një njoftim se gjendet në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Prishtinë gjegjësisht në Agjencinë e Regjistrimit Civil, por nga shkresat e lëndës konstatohet se ftesa është dërguar në emër të Kosovar Aliut, Kolegji konstaton se edhe sikur të qëndron pretendimi se ankuesi ka qenë në takim zyrtar në Prishtinë (edhe pse nga shkresat e lëndës është pa qartë çështja e takimit), ankuesi është i detyruar ta njoftoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë.

Kolegji nga shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 19.04.2023 në ora 12:51 i sqaron mbikëqyrëses së drejtpërdrejt për arsyen e mungesës në punë më datë 19.04.2023, por askund nuk e përmend që ka qenë në takim zyrtar në Prishtinë, me çka vetë ankuesi bie në kundërtënie me pretendimet e tij dhe shkresat e lëndës, prandaj shihet qartë që ankuesi është larguar nga zyra e gjendjes civile duke mos njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të tij.

Kolegji, nisur nga konstatimet e më sipërme dhe duke analizuar dispozitat ligjore të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si ligji i aplikueshëm, respektivisht nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar se : ***përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit,*** konstaton se veprimi i ankuesit duke mbyllur zyrën dhe mos ofrimin e shërbimeve për palët i ka konsumuar të gjitha elemente e shkeljes disiplinore, sidomos largimi nga zyra duke mos njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, prandaj me këto veprime ka ra ndeshë me nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, respektivisht duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 9 paragrafin 4, 5, dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet saktësisht se: ***„A.Përgjegjës për vijueshmëri në punë të zyrtarëve publik, është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore”*** si dhe ***6.Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë’.***

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se vërejtja është shqiptuar në pajtim me nenin 47, paragrafi 1, si dhe nenin 48, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/l – 114 për Zyrat e Publikë, ku përcaktohet se; **1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”.**

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A.nr. 773/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Kryetarit të Komunës së Gjakovës;

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës;

Arkivit të KPMSHCK-së,